


Seance Plenore



REPUBLIK A E SHQIPËRISË
KUVENDI

GRUPI PARLAMENTAR I PARTISË SOCIALISTE

Nr. 4683 prot.

Tiranë, më 10/12/2024

Lënda: Depozitim projektligji.

Drejtuar: Znj. Elisa SPIROPALI
Kryetare e Kuvendit të Shqipërisë

E nderuar Znj. Kryetare,

Bazuar në nenin 81 pika 1, të Kushtetutës të Republikës së Shqipërisë dhe nenin 68, të Rregullores së Kuvendit, Ju paraqes për shqyrtim dhe miratim projektligjin “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 55/2015 "Për investimet strategjike në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar”.

Ju faleminderit.

DEPUTETI PROPOZUES

Paqendra Resulej



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI

PROJEKTLIGJ

Nr. ____ /2024

PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN NR. 55/2015, "PËR INVESTIMET
STRATEGJIKE NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË", I NDRYSHUAR

Në mbështetje të neneve 78, 81, pika 1, dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozim të një deputeti,

VENDOSI:

Në ligjin nr. 55/2015, "Për investimet strategjike në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

Neni 1

Neni 3, Pika 8, "Konsolidimi i tokës" ndryshon si më poshtë:

"Konsolidimi i tokës" është tërësia e masave me qëllim saktësimin hartografik, ripërshtatjen apo ristrukturimin e planifikuar të pronës, reregjistrimin e pasurisë, ndarjen e pasurisë, ndryshimin e regjimit juridik dhe destinacionit të pasurisë, qartësimin e statusit të pronësisë, përfundimin me prioritet të proceseve kalimtare dhe atyre të posaçme të pronësisë, dhe çdo masë tjetër që mundëson gëzimin, ndryshimin e destinacionit të përdorimit dhe shfrytëzimit të tokës në çdo kombinim."

Poshtë pikës 8 shtohet një pikë tjetër "Verifikimi Kadastral" si më poshtë:

"Verifikimi Kadastral" është tërësia e verifikimeve të kryera në bashkëpunim me organet e qeverisjes qendrore dhe vendore me qëllim marrjen e informacionit lidhur me pasuritë e paluajtshme të propozuara për zhvillim, si dhe përdorimin aktual ose të planifikuar të tyre. Ky verifikim përfshin pa u kufizuar në evidentimin nëse këto pasuri janë objekt i procedurave administrative të kthimit ose kompensimit të pronës; objekt i një procesi gjyqësor për titullin e

pronësisë; objekt i procedurave administrative të legalizimit; objekt brenda rrejtit të zonave të mbrojtura; objekt me status “monument kulture”, “zonë historike” dhe sipërfaqe me status “zonë arkeologjike” etj.

Neni 2

Në nenin 6, bëhen këto ndryshime:

Pas pikës 2, shtohet pika 2/1 si më poshtë:

“Portofoli i investimeve për promovim nga ana e Agjencisë përbëhet nga:

- a) *Planet 3 (tre) vjeçare të strategjisë të zhvillimit të investimeve, sipas fushave të përgjegjesisë të secilës ministri, si dhe kalendari 1 (një) vjeçar i projekteve të investimit për të cilat ministrat janë iniciatore/ propozuese apo përgjegjëse dhe projektfisha përkatëse për projekte sipas përcaktimeve të këtij ligji. Ky portofol investimi, për çdo fushë përgjegjësie, depozitohet çdo fillim viti kalendarik, fillimisht tek ministria përgjegjëse për ekonominë dhe pas vlerësimit nga kjo e fundit depozitohet tek Agjencia, me qëllim promovimin e këtyre investimeve tek investitorët.*
- b) *Fondi i Pasurive të Paluajtshme për Mbështetjen e Investimeve Strategjike.*

Neni 3

Në nenin 8, poshtë pikës 5 shtohet një pikë tjetër, si më poshtë:

“Statusin “Investim/investitor strategjik, procedurë e asistuar” e përfitojnë gjithashtu investitorët/projektet investuese, për të cilat, pavarësisht se nuk janë parashikuar të realizohen në një nga sektorët e përcaktuar në pikën 1, të këtij neni, parashikohet që vlerën totale të kapitalit investues të projektit ta kenë të barabartë ose më të madhe se 50 000 000 (pesëdhjetë milionë) euro dhe pasi të kenë marrë miratimin paraprak të ministrisë së linjës.

Neni 4

Në nenin 10, bëhen ndryshimet si më poshtë:

Shtohet pika 6/1 si më poshtë:

“Agjencia ndjek zbatimin e vendimit të Komitetit të Investimeve Strategjike”, përmes planit të veprimit të miratuar nga Komiteti i Investimeve Strategjike (KIS) bazuar në parashikimet e legjislacioneve sektoriale.

Shtohet pika 9, si më poshtë:

“1. Agjencia, në përputhje me ligjin organik, ka të drejtë të ofrojë shërbime dhe të realizojë të ardhura, në funksion të qëllimit e të veprimtarisë së saj.

2. Të ardhurat e krijuara nga veprimtaria e agjencisë dhe donacionet, kalojnë 30% në favor të Buxhetit të Shtetit dhe 70% në favor të Agjencisë, të cilat do të përdoren për qëllime promovimi për tërheqjen e investimeve në Shqipëri”.

Neni 5

Në nenin 13, bëhen ndryshimet si më poshtë:

Pika 1/1, shtohet si më poshtë:

a) *Çdo subjekt investues/investitor përjashtohet nga përfitimi i çdo mase mbështetëse sipas këtij ligji nëse është ose ka qenë i dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë ose është nën hetim apo ndjekje penale, për kryerjen e veprave penale sipas përcaktimeve të legjislacionit për prokurimet publike që përfshijnë por pa u kufizuar në veprat penale si më poshtë:*

- i. Fshehje të të ardhurave;*
- ii. pjesëmarrje në grup të strukturuar kriminal, organizatë kriminale bandë e armatosur, organizatë terroriste;*
- iii. korrupsion;*
- iv. mashtrim;*
- v. pastrim parash apo financim i terrorizmit;*
- vi. vepra me qëllime terroriste ose penale të lidhura me veprimtari terroriste;*
- vii. organizim, drejtim ose financim i veprimtarisë së prodhimit dhe shitjes së lëndëve narkotikëve, si dhe i veprimtarisë së trafikimit të narkotikëve;*
- viii. Falsifikim;*
- ix. Shfrytëzim i punës së të miturve dhe forma të tjera të trafikimit të qenieve njerëzore*

b) *Këtu përfshihet çdo anëtar i një organi administrativ, drejtues ose mbikqyrës i një subjekti investues, aksionar ose ortak i tij, ose person që ka kompetenca përfaqësuese, vendimarrëse ose kontrolluese brenda tij.*

c) *Investitori nuk i nënshtrohet vlerësimit paraprak, nuk kualifikohet, përjashtohet nga masat mbështetëse sipas këtij ligji nëse:*

- i. konstatohet nga Agjencia në bashkëpunim me organet tatimore apo nga organet ligjzbatuese se ka paraqitur të dhëna dhe deklarime financiare të rreme duke shmangur detyrimet tatimore;*
- ii. ndodhet në kushtet e konfliktit të interesit, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi apo nuk ka deklaruar pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit të Biznesit pronarët përfitues, aksionarët ose ortakët sipas legjislacionit në fuqi.*

Neni 6

Në nenin 17, bëhen ndryshimet si më poshtë:

Përpara pikës 1 shtohet pika 1, si më poshtë:

“1. Agjencia kryen procesin e verifikimit kadastral të gjurmës së propozuar. Në rast se pas këtij verifikimi rezulton se projekti është i mundshëm për t’u realizuar, subjekti investues vijon me procedurat e mëtejshme për dorëzimin e projektit të investimit të shoqëruar me dokumentacionin e plotë mbështetës ligjor, teknik dhe financiar”.

Neni 7

Në nenin 19, bëhen ndryshimet si më poshtë:

Titulli i nenit, ndryshon si më poshtë:

“Pezullimi i përkohshëm, anulim dhe shfuqizim të vendimit të Komitetit të Investimeve Strategjike”

Neni 19 ndryshon si më poshtë:

“1) Komitetit i Investimeve Strategjike vendos pezullimin e përkohshëm për një periudhë të përcaktuar rast pas rasti të çdo veprimi nga ana e institucioneve shtetërore të përfshira në dhënien e masave mbështetëse, në rast se gjatë zbatimit të projektit, konstatohet se ka mospërbushje të detyrimeve të marra përsipër nga ana e investitorit dhe mosrespektim të afateve të caktuara. Pezullimi ka efekt deri në momentin e plotësimit të afatit dhe përbushjes tërësisht të detyrimeve nga ana e investitorit.

2) Në rastet kur pas kalimit të afatit të caktuar nga Komitetit të Investimeve Strategjike në vendimin e pezullimit të përkohshëm, kur investitori nuk i përmbush tërësisht detyrimet e marra përsipër, Komiteti i Investimeve Strategjike, shfuqizon vendimin për dhënien e statusit investim/investitor strategjik dhe ngarkon institucionet për ndjekjen e procedurave për rregulimin e pasojave dhe masat korrigjuese..

3) Në rast se përgjatë përgatitjeve, zhvillimit dhe zbatimit të projektit investues strategjik, Komiteti i Investimeve Strategjike konstaton dhe vërteton se në projektin investues ka të dhëna të pavërteta apo ndryshim të të dhënave të dala rishtazi, mbi bazën e të cilave nuk do të ishte vendosur për përfshirjen e këtij projekti në procedurën e asistuar/e veçantë, Komiteti i Investimeve Strategjike vlereson anulimin e vendimin për dhënien e statusit “Investim/investitor strategjik, procedurë e asistuar/e veçantë” dhe njofton autoritetet përgjegjëse..”.

Neni 8

Në nenin 20, bëhen ndryshimet si më poshtë:

Titulli i nenit, ndryshon si më poshtë:

“Detyrimet e investitorit pas shfuqizimit apo anulimit të vendimit për dhënien e statusit”

Pika 1, ndryshon si më poshtë:

Shfuqizimi apo anulimi i vendimit për dhënien e statusit ngarkon investitorin me përgjegjësi civile dhe/ose penale për dëmin e shkaktuar, sipas legjislacionit në fuqi.

Pika 2, ndryshon si më poshtë:

“Në rastet e shfuqizimit apo anulimit të vendimit për dhënien e statusit, sipas parashikimeve të këtij ligji, ne perputhje me Vendimin e Komitetit të Investimeve Strategjike, ministri/të përgjegjëse të fushës përkatëse ndërmarrin veprimet e nevojshme ligjore për rregullimin e pasojave, sipas legjislacionit në fuqi”.

Neni 9

Neni 29, ndryshon si më poshtë:

1. Në funksion të realizimit të një projekti investues strategjik, Komitetit të Investimeve Strategjike, pas marrjes së mendimit paraprak nga institucionet kompetente mund të miratoj si mase mbështetëse me kusht përdorimin e brigjeve të deteve, liqeneve, lumenjve dhe shtreterve të tyre, si dhe zonave përkatëse.
2. Në përputhje me Vendimin e Komitetit të Investimeve Strategjike, lidhet marrëveshja përkatëse ndërmjet Agjencisë Kombëtare të Bregdetit dhe Investitorit, për një periudhë jo më të gjatë se 30 vjet sipas koordinatave të përcaktuara në vendim. Modeli tip i marrëveshjes miratohet me vendim të Këshillit të Ministrave.
3. Tarifa që aplikohen për lejin e përdorimit të brigjeve përcaktohen me vendim të Këshillit Bashkiak.
4. Për efekt të statusit, afatit të përdorimit dhe tarifimit, përdorimi i brigjeve në funksion të investimeve strategjike në fushën e turizmit, i nënshtrohet në çdo rast rregullave të këtij neni, pavarësisht përcaktimeve të legjislacionit të posaçëm të fushave të tjera.
5. Në çdo rast, gëzimi i përdorimit të brigjeve të deteve, liqeneve dhe lumenjve si stacione plazhi, fillon efektet pas vënies në funksion të strukturave akomoduese turistike.

Neni 10

Në nenin 36, togëfjalëshi “data 31 dhjetor 2024”, zëvendësohen me togëfjalëshin “data 31 dhjetor 2026”.

Neni 34 i igjit në fuqi ndryshon si më poshtë:

Neni 11

1. Ky ligj zbatohet edhe për ato investime strategjike që janë në proces të zhvillimit të tyre apo për të cilat nuk është nënshkruar ende një kontratë ndërmjet institucionit/entit/autoritetit publik dhe investitorit strategjik.
2. Masat mbështetëse që i janë miratuar me Vendim të Komitetit të Investimeve Strategjike një projekti që ka fituar statusin “investim/investitor strategjik procedurë e veçantë” ose “procedurë e asistuar” sipas neneve 21, 22, 26, 27 dhe 28 ligjit nr.55/2015 “Për investimet strategjike në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, para hyrjes në fuqi të ndryshimeve të reja të këtij ligji, do

të realizohen sipas parashikimeve dhe procedurave të parashikuara në Planin e Zbatimit të vendimit përkatës të KIS, në Ligjin nr. 55/2025, të ndryshuar dhe aktet nënligjore të dala në dhe për zbatim të tij.

3. Për pasuritë shtetërore për të cilat Komiteti i Investimeve Strategjike ka vendosur që të kalojnë në Fondin e Pasurive të Paluajtshme për Mbështetjen e Investimeve Strategjike, në funksion të mbështetjes shtetërore për realizimin e një investimi që ka fituar statusin “investim/ investitor strategjik procedurë e veçantë” ose “procedurë e asistuar” sipas nenit 31 të ligjit nr. 55/2025, i ndryshuar, për të cilat ende nuk është miratuar Vendimi i Këshillit të Ministrave, ky i fundit do të propozohet dhe miratohet sipas parashikimeve të miratuara në Planin e Zbatimit të vendimit përkatës të KIS, në ligjin nr. 55/2015, të ndryshuar dhe aktet nënligjore të dala në dhe për zbatim të tij.

4. Rregullat e vendosura nëpërmjet nenit 9 të këtij projektligji, që ndryshon nenin 29 të ligjit nr. 55/2015, i ndryshuar zbatohen edhe për kërkesat në shqyrtim e sipër, si edhe për rastet kur është miratuar më parë vendimi përkatës i KIS por nuk është lidhur ende marrëveshja e përdorimit të brigeve, në kohën e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

5. Projektet e investimit që kanë përfituar statusin “investim/investitor me potencial strategjik”, sipas ligjit nr. 55/2025, të ndryshuar dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 1024 datë 16.12.2015 “Për miratimin e projekteve me statusin “Projekt me potencial Strategjik” do të vijojnë të mbështeten me procedura të posaçme administrative favorizuese, lehtësuese apo përshpejtuese, si dhe me dhënien e asistencës dhe ofrimit të shërbimeve, sipas këtyre akteve. Por, aplikimi për marrjen e statusit përfundimtar, do të bëhet sipas dispozitave të këtij ligji.

Neni 12

Ngarkohen institucionet përgjegjëse për ndryshimet në nënligjore në zbatim të këtij ligji, brenda 6 muajve nga hyrja e tij në fuqi.

Neni 13

Ky ligj hyn në fuqi menjëherë, botohet në Fletoren Zyrtare dhe i fillon efektet me 1 janar 2025.

KRYETARE

Elisa Spiropali

Miratuar në datën __. __. 2024